



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.370, Datë 13.11.2023

PËR
“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT PËR
PROKURORIN ARQILE KOÇA”

Bazuar në nenet 143, 149/a, **germa “e”**, 149/ç, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, nenin 9 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 164, pika 8, nenin 189, pika 1, **germa “a”** të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 8 të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Arqile Koça, si ekspert për përgatitjen e një manuali mbi jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në lidhje me çështje të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, për një periudhë 3 (tre) mujore, jashtë orarit zyrtar të punës.
2. Të njoftohen për këtë vendim zoti Arqile Koça dhe Prokurori i Përgjithshëm.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 13.11.2023.

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

